



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 11 nëntor 2015

Numri i lëndës: 2014-32

L.O.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 11 nëntor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURA

1. Ankesa është regjistruar me 11 qershor 2014.
2. Ankuesja ka kërkuar nga Paneli që identiteti i saj mos të bëhet publik, për shkak të shqetësimeve rreth sigurisë. Paneli e pranoi këtë kërkesë.
3. Me 17 nëntor 2014, Paneli vendosi ta njoftonte rreth ankesës shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it, duke e ftuar atë të paraqes vërejtje me shkrim rreth ankesave. Gjithashtu Paneli vendosi të shqyrtoj meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (në pajtim me

rregullën 30 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Punës, më tutje si RrP).

4. Vërejtjet e ShM-së janë pranuar me datën 20 tetor 2015, e pas kësaj ato i janë komunikuar ankueses për vërejtje shtesë.
5. Me 11 maj 2015, ankuesja ka dërguar vërejtjet e saja shtesë, të cilat pastaj u janë dërguar ShM-së për informim.
6. Me 27 tetor 2015, në përgjigje të kërkesës së Panelit, ShM-ja ka parashtruar informata shtesë në lidhje me lëndën. Parashtruesat e tij i janë dërguar ankueses për informim.

FAKTET

I. RRETHANAT E LËNDËS

7. Me 29 qershor 1999, A.A., i cili ishte bashkëshorti i ankueses, ka thirrë vajzën e tij menjëherë pas orës 13:00 për ta informuar se ai ishte duke ardhur rrugës për në shtëpi. Ai kurrë nuk u kthye në shtëpi dhe që nga atëherë asnjëherë nuk u dëgjua për të. Vendndodhja e tij apo vendi i mbetjeve të tij mortore është i panjohur. Në atë kohë, A.A. ka punuar mjek në spitalin e Prishtinës. Ai ishte me përkatësi etnike serbe.
8. Zhdukja e A.A.-së ishte raportuar menjëherë tek zyrtarët e lartë të KFOR-it britanik, KNKK-së, Kryqit të Kuq të Serbisë, Zyrës Ndërlidhëse të UNMIK-ut në Beograd dhe autoriteteve qeveritare të Serbisë.
9. Në kohën e parashtrimit të kësaj ankese, A.A. vazhdon të raportohet si i zhdukur në faqen e internetit të Komisionit Ndërkombëtar të Personave të Zhdukur.
10. Me 15 prill 2009, L.O. ka parashtruar ankesë në Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) të UNMIK-ut. Në vendimin e tij të datës 23 prill 2013, PKDNj-ja ka konstatuar se ka pasur shkelje të të drejtave të ankueses sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa). PKDNj-ja ka konstatuar se ishte e paqartë se çfarë hapash hetimor ishin ndërmarrë midis viteve 1999 dhe 2002 për të vendosur se çfarë kishte ndodhur me A.A. Paneli më tej kishte gjetur se disa aktivitete hetimore mundet se ishin zhvilluar në vitin 2002 dhe 2004, edhe pse në dosje nuk ka pasur hollësi lidhur me atë se çfarë kanë mundur me qenë. Në lidhje me hapat hetimore të dokumentuara në dosjen e lëndës, PKDNj-ja ka identifikuar të meta serioze dhe ka gjetur se aktivitetet e ndërmarra dukeshin “të sipërfaqësishme”. PKDNj-ja i bëri thirrje EULEX-it që të marrë të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar që hetimi penal për zhdukjen e A.A.-së të vazhdojë në përputhje me nenin 2 të Konventës.

11. Më 9 dhjetor 2008 përgjegjësia e UNMIK-ut për çështje të policisë dhe drejtësisë në Kosovë përfundoj me marrjen e përgjegjësiwe operacionale nga EULEX-i.
12. Më 18 qershor 2013, përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së (PSSP-ja) ka konfirmuar se do të vazhdojë të nxisë EULEX-in dhe autoritetet e tjera kompetente që të vazhdojnë të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshme për të siguruar që hetimi penal lidhur me zhdukjen ose ndoshta vrasjen e të afërmit të ankueses të vazhdojë dhe autorët të sillen para drejtësisë.
13. EULEX-i ka thënë se ishte njoftuar rreth rastit atëherë kur vendimi i PKDNj-së ishte dërguar nga zyra ndërlidhëse e UNMIK-ut për sundimin e ligjit me 2 korrik 2013.
14. Me 25 korrik 2013, kryeprokurori i EULEX-it ka dërguar rastin tek ekipi mobil i prokurorëve të EULEX-it për vlerësim paraprak. Pak kohë më pas, njësisia e EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjHKL) nisi një hetim lidhur me këtë rast.
15. Në mesin e janarit 2014, rasti i ishte caktuar një prokurori të EULEX-it që punon në një ekip mobil së bashku me një prokuror vendas. Hapat hetimorë përfshinin marrjen në pyetje në procedurën paraprake, përpjekjet për t'i gjetur dëshmitarët dhe një kërkesë për ndihmë ligjore reciproke.
16. Me 7 prill 2014, ankuesja ka dërguar një letër me postë elektronike në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) në të cilën ajo e autorizoj znj. Jovanka Stojsavljevic-Savic-in që të veproj në emër të saj pranë EULEX-it dhe pyeti nëse ndonjë e dhënë në rastin e saj ishte ruajtur dhe çfarë hapash hetimorë ishin ndërmarrë.
17. Me 14 prill 2014, PSRK-ja dërgoj kërkesën e ankueses në Ekipin mobil të prokurorëve në Prishtinë të EULEX-it, duke e informuar atë që PSRK-ja nuk mban asnjë të dhënë lidhur me rastin dhe ka kërkuar nga Ekipi mobil informata rreth rastit.
18. Me 2 maj 2014, një prokuror nga Ekipi mobil i EULEX-it ka informuar përfaqësuesin e ankueses se pala e dëmtuar mund të përfaqësohet vetëm nga një person i cili ishte anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, kështu që asaj si përfaqësuese e ankueses nuk mundej t'i zbuloheshin asnjë informacion mbi rastin.
19. Ankuesja u përgjigj, duke e referuar prokurorin tek neni 63 par. 3 i KPP-së që parasheh se pala e dëmtuar mund të përfaqësoj veten dhe ka kërkuar të dhëna lidhur me fatin e burrit të saj.
20. Më 15 maj 2014, një prokuror i EULEX-it u përgjigj se ankuesja mund të përfaqësoj veten në procedurat penale. Megjithatë, çështja ishte në hetim e sipër dhe ka pasur mundësi që kopjimin ose fotokopjimi i

ndonjë materiali të rastit të mund të rrezikoj qëllimin e hetimit. Mbi këtë bazë, u sugjerua se EULEX-i nuk mund t'i zbuloj asaj asnjë informacion.

21. Me 19 maj 2014, ankuesja përsëri ka kërkuar nga prokurori i EULEX-it që të ofroj hollësira mbi masat e ndërmarra hetimore. Ankuesja tregon se ajo nuk ka marrë asnjë përgjigje rreth kësaj kërkesë shtesë.
22. Me 24 maj 2014, prokurori i EULEX-it u njoftua se Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) kishte kërkuar informata për rastin nga Njësia e Hetimeve të Krimeve të Luftës. Me 25 maj 2015, TFHS-ja ka konfirmuar se ata ishin duke hetuar rastin. Hetimi nga Ekipi Mobil ishte mbyllë për këtë arsye.
23. Nga informatat e Panelit është evidente se TFHS-ja ka hetuar zhdukjen e burrit të ankueses nga marsi i vitit 2013 dhe ishte në kontakt të rregullt me të, duke e takuar atë tri herë gjatë periudhës dy vjeçare.
24. Në parashtrimet e tij të datës 27 tetor 2015, shefi i Misionit ka informuar Panelin se pasi që hetimi penal është aktualisht në pritje, asnjë informacion i hollësishëm rreth masave hetuese nuk mund të jepet. Siç e shpjegoj ai, kjo është për shkak të natyrës së ndjeshme, konfidencialitetit dhe integritetit të hetimit, si dhe sigurisë së dëshmitarëve. Megjithatë TFHS-ja ka njoftuar se është bërë një kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare. TFHS-ja gjithashtu tregoj se ankuesja ishte informuar në lidhje me gjendjen aktuale të hetimit dhe hapat e ardhshëm hetimore që do të ndërmerreshin.

II. ANKESAT

25. Ankuesja i referohet dy të drejtave të veçanta themelore që reflektohen në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) nën pjesën e tij procedurale, e cila garanton të drejtën themelore të personit për jetë dhe parashih obligimin për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; Neni 3 i Konventës sa i përket vuajtjes për fatin që nuk dihej të të afërmeve që ju shkaktohen ankuesve. Natyra e ankesës po ashtu ka të bëjë me garancitë që parashihen në neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe neni 13 (e drejta për një mjet efektiv) e Konventës.

III. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin për Sundimin e Ligjit Evropian në Kosovë, EULEX-i KOSOVË

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i KOSOVË do t'i ndihmoj institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin ligjit në përparimin e tyre drejt stabilitetit dhe besueshmërisë në zhvillimet e mëtutjeshme dhe forcimin e sistemit të pavarur shumetnik të drejtësisë, të policisë, të doganës duke siguruar që këto institucione nuk do të ndikohen politikisht dhe do t'ju përmbahen standardeve të pranura ndërkombëtare dhe praktikave më të mira evropiane.

Neni 3 Detyrat

Me qëllim të përmbushjes së Deklaratës së Misionit të përcaktuar në nenin 2, EULEX-i KOSOVË do të:

(...)

(h) merr përgjegjësi të tjera, qoftë ndarazi apo në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Kosovës, për të siguruar zbatimin dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe

Ligji mbi kompetencat

Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në KOSOVË (në fuqi deri më 7 maj 2014)

Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale

(...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtimin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të paraparë sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja:

(...)

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë të prokurorëve publik të Kosovës

12.1 Në çdo fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtroj detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikoj hetimin apo ndjekjen e duhur të një veprë penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një veprë penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkoj nga kryeprokurori i

zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktoj: a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale, b) apo cilindo prokuror të EULEX-it që do të marrë përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

12.2 Nëse kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e kryeprokurorit të EULEX-it, kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftoj kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët i cili do të respektohet nga kryeprokurori i zyrës kompetente.

12.3 Në rrethana urgjente ose kur vonesa mund të ndikoj në kryerjen apo rezultatin e hetimit, ndjekjes penale apo zhvillimit të drejtë të procedurës, kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmerret çdo veprimi urgjent procedural apo të caktoj cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

Ligji Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës

Neni 3 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

.....

3. Pas nenit 1 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 1.A me tekstin si në vijim:

Neni 1.A Rastet në proces

Për qëllime të këtij ligji, rast në proces nënkupton:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin;
2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

.....

9. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7 Autoriteti dhe kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1. Prokurorët e EULEX-it do të kenë autoritet dhe përgjegjësi t'i kryejnë funksionet e tyre, përfshirë autoritetin për kryerjen e hetimeve penale ashtu si përcaktohet në nenin 2.1 të këtij ligji, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.

7.2. Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të PSRK-së në pajtim me ligjin mbi PSRK-në.

7.3. Prokurorët e EULEX-it janë të integruar në sistemin prokurorial të Kosovës dhe do të ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me legjislativonin në fuqi në Kosovë.

7.4. Rastet e udhëhequra nga prokurorët e EULEX-it të përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji do të vazhdojnë të menaxhohen në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (2008) dhe të Ligjit për PSRK-në (2008).

7.5. EULEX-i KOSOVË do të caktoj prokurorë që të ndihmojnë lidhur me zbatimin, sipas marrëveshjes, të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja.

7.6. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, prokurorët e EULEX-it do t'i bashkërendojnë aktivitetet e tyre me kryeprokurorin përgjegjës për zyrën të cilën ata janë të vendosur.

7.7. Siç parashihet në Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit Në Kosovë (Prill 2014), prokurorët e EULEX-it që punojnë në kuadër të TFHS do të gëzojnë të gjitha kompetencat dhe autonominë e nevojshme për të vazhduar hetimet e TFHS dhe të kryejnë funksionet prokuroriale rezultuese në mënyrë të pavarur pa ndërhyrje apo ndërprerje. Paragrafi 7.6 nuk zbatohet për prokurorët që punojnë në TFHS.

10. Pas nenit 7 të ligjit, shtohen dy nene të reja 7.A dhe 7.B me tekstin si në vijim:

Neni 7.A Autoriteti i prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme

Në rrethana të jashtëzakonshme, një rast mund t'i caktohet në prokurori të EULEX-it nga një vendim i përbashkët i kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX-it KOSOVË.

Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

Neni 5 Kompetenca e veçantë e PSRK-së

5.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë që të hetoj dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:

.....

e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);

f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë në karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);

...

n) krimi i organizuar (neni 274, KPPK), kërcënimi gjatë procedurave penale për krim të organizuar (neni 310, KPPK);

.....

Neni 9 Kompetenca plotësuese e PSRK-së

9.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë plotësuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si në vijon:

.....

b) nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPPK);

.....

h) vrasja (neni 146, KPPK), vrasja e rëndë (neni 147, KPPK);

i) marrja e pengjeve (neni 143, KPPK);

j) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK);

k) rrëmbimi i personit (neni 159, KPPK);

.....

Neni 15.A Dispozitat për TFHS

1. Siç parashihet në Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (Prill 2014), në kuadër të PSRK-së, do të funksionoj Task Forca Speciale Hetuese (TFHS), si njësit i ndarë, i pavarur me funksion hetues dhe prokurorial me të gjitha kompetencat dhe autonominë e nevojshme.

2. TFHS nuk do t'i nënshtrohet udhëheqjes apo mbikëqyrjes së kryeprokurorit apo zëvendës kryeprokurorit të PSRK-së, as mbikëqyrjes së përgjithshme të kryeprokurorit të shtetit.

3. Prokurorët dhe hetuesit e TFHS do të kenë kompetencat e prokurorëve të EULEX-it dhe Policisë së EULEX-it siç është rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

26. Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) është themeluar në vitin 2011 që të kryej hetime të pavarura penale rreth pretendimeve të akuzave për krime të luftës dhe krim të organizuar, të përfshira në raportin e Këshillit të Evropës të janarit të vitit 2011 nga senatori Dick Marty me titull: "Trajtimi jonjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë" (Raporti i KE-së). Në shtator dhe tetor të vitit 2011, Komiteti Politik dhe i Sigurisë i Bashkimit Evropian ka ndryshuar Planin Operacional të EULEX-it për të siguruar themelimin e TFHS si një organ i veçantë, por në kuadër të Misionit. Prandaj një prokuror i caktuar në TFHS është formalisht edhe prokuror i EULEX-it. OPLAN-i parashikon që TFHS do të veproj pjesërisht nga Brukseli, por me staf edhe në Kosovë. Fatkeqësisht, OPLAN-i nuk është në dispozicion për publikun. Megjithatë ajo që është e njohur nga burimet e disponueshme publike është se mandati i TFHS është që të hetoj dhe në qoftë se është e nevojshme të ndjek penalisht individët për krimet e pretenduara në raportin e KE-së. TFHS është një organ autonom që e ka juridiksionin e vet dhe autoritetin ligjor nga Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian që e themelon Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Prandaj, TFHS vepron në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës dhe në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë. Më 10 maj 2012, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar njëzëri

ligjin për bashkëpunim me TFHS. Ligji është bërë që të lejoj TFHS-in që në mënyrë të pavarur të kryen aktivitetet hetimore në territorin e Shqipërisë, ku raportuesi i KE-së, Dick Marty, beson se kishin ndodhur shumica e krimeve të pretenduara. TFHS ka arritur edhe marrëveshje në parim për kornizat e bashkëpunimit me shtetet dhe organizatat e tjera përkatëse për hetimin.

LIGJI

27. Siç u diskutua më sipër, ankesa pretendon se EULEX-i ka shkelur nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës.

Parashtresat nga palët

28. Në parashtrimet e tij, shefi i Misionit ka deklaruar se prokurorët e EULEX-it u njoftuan rreth rastit në vitin 2013, atëherë kur vendimi i PKDNj-së lidhur me këtë rast i ishte dërguar Misionit.
29. Menjëherë pas kësaj, një hetim është iniciuar nga Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës e EULEX-it.
30. Në qershor të vitit 2014, një hetim rreth rastit ishte hapë nga TFHS. Siç u përmend më lart, në paragrafin. 24, ShM-ja ka njoftuar Panelin se ai nuk mund të siguroj informacion të hollësishëm rreth masave hetimore të ndërmarra nga TFHS.
31. Sa i përket pranueshmërisë së ankesës, ShM-ja pohoj se Paneli ishte kompetent që vetëm të shqyrtoj shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i. Prandaj të gjitha ankesat në lidhje me veprimet apo mosveprimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, autoriteteve të KFOR-it, UNMIK-ut apo autoriteteve të Kosovës bien jashtë kompetencave të tij dhe duhet të refuzohen si të papranueshme.
32. Megjithatë ShM-ja pranoj se veprimet e prokurorëve të EULEX-it para fillimit të procedurës gjyqësore në parim hyjnë në kuadër të juridiksionit të Panelit.
33. ShM-ja gjithashtu ka pohuar se Paneli nuk ishte kompetent që të shqyrtoj ankesat rreth shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur para 9 dhjetorit 2009. Bashkëshorti i ankueses ishte zhdukur në vitin 1999. Mbi këtë bazë, ShM-ja është mbështetur në lëndën e Panelit *Thaqi kundër EULEX-it* (nr. 2010-02) për të sugjeruar se nuk kishte "lidhje të vërtetë" në mes të zhdukjes së tij dhe juridiksionit të Panelit. ShM-ja pranoj se hetimi fillestar, regjistrimi i ngjarjeve dhe hollësitë e kontaktit të dëshmitarëve nuk ishin pa të meta. Megjithatë ai shtoj se EULEX-i nuk mund të mbahen përgjegjës për këto e as për dështimin që të hetohet lënda, e cila kishte qenë e pazgjidhur për disa vjet. Mbi këtë bazë ai sugjeron se mungon "lidhja

e vërtetë” në mes të zhdukjes dhe datës 9 dhjetor 2009 si pikënisje e juridiksionit kohor të Panelit në rastin në fjalë.

34. ShM-ja konkludoj se dështimi që të hetohej zhdukja e bashkëshortit të ankueses si dhe vuajtjes së saj më pas nuk i atribuohen EULEX-it dhe se nuk ka shkelje të të drejtave të ankuesit që i ishin atribuar Misionit.
35. Në përgjigjen e saj ndaj vërejtjeve të ShM-së, ankuesja përsëriti parashtresat e saja të dhëna në formularin e aplikimit të parashtruar me 11 qershor 2014. Ajo po ashtu parashtror se ishte e qartë nga deklarata e kryeprokurorit të TFHS se TFHS ka përfunduar hetimin e tij që në mënyrë të mjaftueshme të ngritë akuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të UÇK-së. Megjithatë takimi që ata mbajtën me ankuesen, nuk i ofroj asaj ndonjë hollësi rreth hetimit që ishte ndërmarrë në lidhje me rrëmbimin e burrit të saj, rezultati i asaj pjese të hetimit nga TFHS dhe hapave të mëtejshëm që do të ndërmerren për t'i mundësuar asaj që ta di të vërtetën rreth fatit të bashkëshortit të vet. Sipas mendimit të saj, ai qëndrim ka shkelur të drejtat e saja.
36. Ankuesja pohoj se parashtresat e ShM-së lidhur me hapat e ndërmarrë hetimor nga EULEX-i ishin përgjigje jo të plota dhe jo të duhura. Në veçanti, ajo tregon për atë që ajo e konsideron të jetë mungesa e transparencës në lidhje me hetimin dhe mungesa e informacionit që ajo ka marrë rreth hapave të ardhshëm në proces.
37. Ankuesja ka hedhur poshtë pohimin e ShM-së se ajo ka treguar se ishte e kënaqur me mënyrën se si TFHS po vazhdon hetimin, pasi ajo nuk kishte qenë e informuar rreth masave që po merreshin nga TFHS dhe për këtë arsye nuk mund të komentonte rreth tyre. Ajo pranoj shqetësimet e ngritura në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarit dhe mbrojtjen e personelit të TFHS, por sipas mendimit të saj EULEX-i/TFHS mund dhe duhet të gjejnë një mekanizëm për t'i komunikuar aktivitetet e tyre hetimore në një mënyrë që nuk vazhdojnë t'i shkelin të drejtat e saja.
38. Për më tepër, ajo parashtror se dështimi i vazhdueshëm që të sigurohet një mjet efektiv juridik rreth dështimeve sistemike dhe shkeljeve gjatë një periudhe për gati gjashtëmbëdhjetë vjet, ka shkelur nenin 13 të Konventës dhe nenit 47 të Kartës së Lirive Themelore (e drejta për zgjidhje efektive dhe gjykim të drejtë).

Vlerësimi i Panelit

Mandati i Panelit (Rregulla 25 par. 1 i Rregullores së Punës) dhe kufizimet e pandara të vëna mbi Misionin lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut

39. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e

Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet demokratike ligjore.

40. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do t'i pranoj ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
41. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
42. Paneli tashmë ka vendosur më herët se veprimet e prokurorëve dhe të policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit (për shembull shih *K deri te T kundër EULEX-it*, lëndët nr. 2013-05 deri te 2013-14, 21 prill 2015 § 43; *Krlc kundër EULEX-it*, nr. 2012-21 26 Gusht 2014, § 23; *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28, 15 nëntor 2012, § 35).
43. Paneli tashmë ka pasur rastin të theksoj se Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohen në të gjitha aspektet përkatëse të asaj që mund të pritet prej një shteti (shih vendimin e Panelit në *A,B,C,D kundër EULEX-it* nr. 2012-09 në 2012-12, 20 qershor 2013, § 50; *K deri te T kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 53; krahasoni edhe vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, § 35).
44. Paneli gjithashtu vëren vështirësitë që domosdoshmërisht përfshihen në hetimin e krimeve të rënda në një shoqëri të pasluftës, siç është Kosova (shih *Palic kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, 15 shkurt 2011 § 70; Vendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 44 dhe 62 e tutje). Megjithatë këto vështirësi nuk duhet të shërbejnë për t'i kamufluar apo shpjeguar dështimet që në asnjë mënyrë kuptimplote nuk lidhen me to. Prandaj në secilin rast Paneli do të vlerësoj nëse ndonjë hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur do të kishte qenë i pamundur për arsyet që lidhen me rrethanat e pas konfliktit pavarësisht prej atyre që zhvillojnë hetimin.
45. Prandaj pritjet që janë vënë mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur çështje komplekse kriminale duhet të jenë realiste dhe mos të vënë mbi misionin një barrë të disproporcionale që mandati dhe burimet e saj nuk janë në gjendje të përmbushin (shih vendimin e PKDNJ në lëndët nr. 248/09, 250 / 09 dhe 251/09, cituar më lartë, §§

70-71). Prandaj në çdo rast Paneli pritet të shqyrtoj nëse ka pasur pengesa konkrete dhe reale që mund ta kenë dëmtuar mundësinë që EULEX-i të kryen një hetim të shpejtë dhe efektiv rreth një lënde. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim që të justifikoj të metat operacionale që nuk lidhen me sfida konkrete dhe të dukshme.

46. Në secilin rast, autoritetet hetimore priten të veprojnë shpejt për aq sa është e arsyeshme dhe të përdorin burime në përputhje me nevojën dhe mundësinë për zgjidhjen e lëndës. Përderisa autoritetet hetuese nuk mund të priten t'i zgjidhin të gjitha lëndët e sjella para tyre, prej tyre pritet që në çdo rast të veprojnë me kujdes, shpejtësi dhe efikasitet të tillë që e pasqyrojnë seriozitetin e lëndës që është duke u hetuar (shih *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë* [GC], § 191, GjEDNj-së 2009; *Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, cituar më lartë, § 63). Një angazhim dhe përkushtim i rreptë me këto standarde është veçanërisht i rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit si EULEX-i, që ka për qëllim të shërbejë si shembull i përkushtimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për ndërtimin e një ndjenje të fortë të përgjegjësisë ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Çfarëdo standardi më pak se ky do të rrezikonte krijimin e një ndjenje pajtimi me mosndëshkimin dhe mospërfilljen e kërkesës legjitime të viktimave për drejtësi dhe llogaridhënie (shih vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, § 80).
47. Në këtë kontekst, nuk ka asnjë dyshim se hetimi i fatit të të vararëve dhe të zhdukurve, pa dallim feje apo etnie, duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in si mision i sundimit të ligjit për të cilën ai duhet të pajiset me burime të mjaftueshme.

Lidhja e mjaftueshme kohore me sjelljen në fjalë - Kompetenca e Panelit ratione temporis

48. Siç u përmend më lartë, ShM-ja argumenton se Panelit i mungon juridiksioni *ratione temporis* mbi këtë lëndë në mungesë të lidhjes së mjaftueshme kohore midis sjelljes në fjalë dhe parashtrimit të ankesës në Panel. Paneli nuk pajtohet.
49. Së pari, ankesa nuk ka të bëjë me vrasjen aktuale të bashkëshortit të ankueses, por ka të bëjë me atë që ankuesja thotë se është dështim i vazhdueshëm që të hetohet plotësisht dhe në mënyrë efektive kjo lëndë. Në këtë kuptim, ankesa ka të bëjë me shkeljet e pohuara të pjesëve procedurale, kundrejt pjesëve substanciale të neneve 2 dhe 3 (përveç shkelje të neneve 8 dhe 13 të Konventës), që sipas saj janë të vazhdueshme.
50. Së dyti, Paneli konstaton se ankuesja asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga ndjekja e pretendimit të saj. Për këtë qëllim ajo ka kërkuar nga autoritete të ndryshme (vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë UNMIK-un, qeverinë britanike, degë të ndryshme të EULEX-it), të cilat

ajo ka menduar se mund t'i ndihmonin të merrte informata lidhur me këtë çështje. Fakti që një sërë autoritetesh pasuan njëri-tjetrin në hetimin e kësaj çështje, jo gjithmonë me qartësi të madhe për sa i përket përgjegjësi të tyre përkatëse, me të drejtë nuk mund që t'i ngarkohet asaj.

51. Së treti, Paneli konstaton se EULEX-i ka qenë dhe vazhdon të jetë i përfshirë (nëpërmjet TFHS) në hetimin e kësaj çështjeje. Një sjellje e tillë padiskutim hyn në kuadër të kompetencës *ratione temporis* së Panelit. Me qëllim të garantimit të mbrojtjes efektive të të drejtave të ankuesve, kjo periudhë nuk mund që në mënyrë kuptimplote të ndahet nga hetimi që është kryer deri në këtë fazë (krahaso *Thaqi kundër EULEX-it*, nr. 2010-02, 14 shtator 2011, § 85-89).
52. Bazuar në atë që u tha më sipër, Paneli është i mendimit se ka juridiksion *ratione temporis* mbi këtë lëndë, pasi ekziston një "lidhje e vërtetë" midis shkeljes së pretenduar të të drejtave të ankueses dhe juridiksionit të Panelit (lënda *Thaqi kundër EULEX-it*, cituar më lartë, §§ 85-89).

Kompetenca ratione materiae e Panelit

53. ShM-ja nuk duket se e konteston që Paneli do të ketë kompetencë *ratione materiae* mbi këtë çështje.
54. Kjo është tashmë e qartë nga fakti se prokurorët e Misionit kanë qenë të përfshirë në hetimin e këtij rasti. Kjo është gjithashtu e qartë nga fakti se akte të tilla mund të përbëjnë krime lufte ose krim etnik, mbi të cilat prokurorët e EULEX-it kanë kompetenca (nenet 5 dhe 9 të Ligjit nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës).
55. Përfshirja ekzekutive e Misionit dhe si rezultat kompetenca e Panelit në këtë çështje është gjithashtu e dukshme nga ajo çfarë i treguesi prej Kombeve të Bashkuara se do të nxisin EULEX-in "dhe autoritetet e tjera kompetente" të vazhdojnë të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshme për të siguruar hetimin penal për zhdukjen dhe vrasjen e anëtarit të familjes së ankueses. Kjo tregon në mënyrë të qartë të kuptuarit nga ana e PKDNj-së dhe nga Kombet e Bashkuara që EULEX-i me të vërtetë ishte kompetent për t'u marrë me këtë rast të veçantë (shih vendimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të datës 18 qershor 2013, lënda në PKDNj).
56. Për më tepër, Paneli konstaton që ShM-ja nuk e konteston se ankuesja si e afërme e ngushtë e personit të zhdukur është kompetente dhe ka qëndruar para trupit gjykues për të kërkuar një mjet juridik për atë që ajo e konsideron si shkelje të të drejtave të saj.

Hetimi para përfshirjes së SIFT në këtë rast

57. Paneli do të shqyrtoj ankesën në lidhje me dy faza të veçanta: së pari, para se SIFT "ta merrte përsipër" përgjegjësinë për të hetuar këtë lëndë; së dyti, pasi TFHS kishte informuar Misionin që do ta hetonte këtë lëndë.
58. Lidhur me periudhën e parë (para-SIFT), Paneli konstaton parashtrirat e ShM-së se një numër hapash janë ndërmarrë për të hetuar këtë rast. Informacioni i siguruar nga ShM-ja lidhur me këto nuk është i tillë që t'i mundësoj Panelit verifikimin e natyrës dhe shtrirjen e këtyre përpjekjeve.
59. Paneli thekson se hapat hetimor duhet të jetë proporcionale me natyrën dhe seriozitetin e shkeljes së pretenduar (*Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [GC], cituar më lartë, § 191; *Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, cituar më lartë, § 63). Në këtë rast, shkelja e pretenduar nuk mund të jetë më serioze. Prandaj ata mund të kenë pritur që Misioni në këtë rast të përfshinte burime të konsiderueshme (në personel, kohë dhe burime). Paneli nuk ka pasur asnjë tregues se kjo ishte kështu dhe tërheq konkluzione të nevojshme nga mungesa e një informacioni të tillë.
60. Nga informacioni që është vënë në dispozicion, Paneli konstaton që nuk ka asnjë tregues se deklaratat e dëshmitarëve janë marrë nga prokurorët e EULEX-it apo se çdo hetim i besueshëm mjeko-ligjor ishte kryer nga Misioni. E Paneli nuk ka as edhe ndonjë tregues të mënyrave të hetimeve që janë ndërmarrë në këtë rast apo çfarë përpjekje janë bërë për t'i identifikuar të dyshuarit. Asnjë informacion nuk i ishte ofruar Panelit që të sugjeronte se prokurorët e EULEX-it kishin kontaktuar burimet e mundshme të informacionit (si për shembull qeverinë britanike). E as deklaratat nuk ishin marrë nga ankuesja, vajza e saj apo ndonjë i afërm tjetër që mund të ketë pasur informacion të vlefshëm rreth hetimit. Me sa duket ka pasur vetëm një kontakt të drejtpërdrejtë verbal mes ankueses dhe Misionit që gjithashtu duket se ka reaguar vetëm kur ishte shtyrë për ta bërë këtë nga ankuesja. Një e dhënë e tillë nuk është e ashtu që të garantoj mbrojtjen procedurale të garantuar nga nenet 2 dhe 3 të Konventës. Gjithashtu mund të thuhet se ka ndikuar negativisht në gëzimin e ankueses në të drejtat e saja sipas nenit 8 dhe 13 të Konventës.
61. Për më tepër, Paneli vëren se reagimi i Misionit ndaj përpjekjeve të ankueses duket se ishte larg prej të qenit i duhur. Përpjekjet e saja të shumta kanë rezultuar që ajo të merrte vetëm masën minimale të informacionit dhe vetëm atëherë kur ajo bënte presion për përgjigje. Për aq sa shihet nga Paneli, pak është bërë që ajo të përfshihet dhe të informohej lidhur me procesin.
62. Paneli gjithashtu duhet të theksoj rëndësinë që autoritetet hetimore duhet të kenë në mënyrën me të cilën komunikojnë me viktimat e shkeljes së të drejtave apo të afërmeve të tyre. Në këtë aspekt, sugjerimi nga prokurori i EULEX-it që ankuesja nuk mund të përfaqësohet në këtë çështje dhe në këtë mënyrë me të cilën i ishte

komunikuar ankueses është veçanërisht për të ardhur keq. Komunikimi në fjalë ka pasqyruar jo vetëm mungesën e takti. Ai po ashtu ishte i gabuar nga pikëpamja ligjore. Paneli nuk duhet të vendos nëse neni 63 (1) të KPP-së ishte me të vërtetë i zbatueshëm për këtë çështje. Prapëseprapë, paragrafi 2 i kësaj dispozite do t'i kishte dhënë një bazë të mjaftueshme ligjore prokurorit që të konsideronte përfaqësuesin e ankueses si të autorizuar në mënyrë të vlefshme për të përfaqësuar atë. Si alternativë, prokurori i EULEX-it mund ta kishte trajtuar kërkesën si të ishte bërë nga vetë ankuesja në përputhje të nenit 63 (3) të KPP-së. Për më tepër, teksti i kësaj dispozite parashikon shprehimisht se një viktimë "mund" të përfaqësohen, kështu që kodi nuk e trajton përfaqësimin si kusht të domosdoshëm (siç është gjithashtu e qartë nga paragrafi 3 i kësaj dispozite). Për më tepër, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre, zyrtarët e EULEX-it janë në çdo kohë të obliguar të sigurojnë që të veprojnë në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Interpretimi i ngushtë dhe në fund i gabuar i prokurorit të EULEX-it i nenit 63 të KPP-së nuk pe ka plotësuar atë standard.

63. Në fund Paneli konstaton se kompetenca dhe përgjegjësia e EULEX-it për të hetuar krimet që bien në kuadër të mandatit të tij nuk është i kushtëzuar nga veprimet e palës së dëmtuar. Në një rast të tillë si ky, EULEX-i është përgjegjës për të vepruar *proprio motu*, me qëllim që të sigurohet se zhdukja është duke u hetuar me kujdes, menjëherë dhe në mënyrë efektive. Prandaj, refuzimi i kërkesave të ankueses për informacion në asnjë mënyrë nuk ka prekur obligimet e Misionit për të garantuar efikasitetin e të drejtave themelore të ankueses (shih në mesin e shumë autoriteteve të tjera, *Ahmet Özkan dhe të Tjerët kundër Turqisë*, nr. 21689/93, § 310, 6 prill 2004; *Isayeva kundër Ruisisë*, nr. 57950/00, § 210, 24 shkurt 2005).
64. Në këto rrethana, letra e prokurorit të datës 2 maj 2014 i EULEX-it ofron dëshmi të mëtëjshme që të drejtat e ankueses nuk ishin garantuar në mënyrë efektive dhe në mënyrë të plotë nga EULEX-i, në veçanti ashtu siç ka të bëjë me të drejtën e saj për të pasur qasje në një zgjidhje efektive sipas nenit 13 të Konventës.
65. Bazuar në atë që u tha më sipër, Paneli konstaton në bazë të informacionit të dhënë se përpjekjet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të ankueses sipas neneve 2, 3 (pjesët procedurale), 8 dhe 13.

Periudha pas-TFHS - Statusi i TFHS kundrejt misionit të EULEX-it

66. Paneli tani shqyrton gjendjen pasi TFHS kishte njoftuar Misionin se po e hetonte këtë rast.
67. Si çështje paraprake, Paneli konstaton mungesën e transparencës dhe qartësisë që prek regjimin ligjor nën të cilin vepron TFHS.

Përderisa Paneli nuk ka nevojë të merret me këtë aspekt të çështjes në thellësi, dëshiron të nënvizojë rëndësinë e përgjithshëm të transparencës lidhur me legjitimitetin dhe besueshmërinë e çdo ndërmarrjeje hetimore, prokuroriale ose gjyqësore.

68. Paneli është i shqetësuar më në veçanti prej dy çështjeve që janë me rëndësi për përmbushjen efektive të përgjegjësive të tij në rastin konkret. I pari ka të bëjë me statusin e TFHS në kuadër të Misionit të EULEX-it dhe në veçanti nëse ata i përgjigjen ShM-së. Çështja e dytë ka të bëjë me çështjen nëse TFHS gëzon një lloj përparësie apo ekskluziviteti mbi lëndët që ka zgjedh që t'i hetoj.
69. Lidhur me çështjen e parë dhe siç u përmend më lartë, TFHS është formalisht pjesë e Misionit. Si e tillë, aktivitetet e saja në parim hyjnë brenda kompetencave të Panelit. Mungesa e transparencës në lidhje me mandatin e saj, bazën e vet ligjore dhe marrëdhëniet e saj institucionale me pjesën tjetër të Misionit, bën gati të pamundur shqyrtimin e aktiviteteve të saj nga ana e Panelin. Paaftësia e ShM-së që të jep më shumë informacion në këtë drejtim e le Paneli me pak alternativa, përpos se të nxjerrë konkluzione të caktuara nga kjo mungesë e informacionit (*AI Nashiri kundër Poloni*, nr. 28761/11, vendim i datës 24 korrik 2014, § 375; *Shamayev dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë dhe Rusisë*, nr. 36378/02, § 503, GjEDNJ 2005-III).
70. Për sa i përket çështjes së dytë, Panelit nuk iu është ofruar asnjë bazë ligjore që do t'i jepte përparësi TFHS ndaj prokurorëve të EULEX-it. E Paneli as nuk ka marrë ndonjë tregues të ndonjë teksti ligjor që do t'i lejonte prokurorët e EULEX të braktisnin hetimin nëse dhe kur ata ishin informuan për qëllimet e TFHS-së për të hetuar këtë rast.
71. Përderisa përfshirjen e TFHS në fund mund të ndihmoj në kërkimin e ankueses për përgjigje dhe drejtësi, Paneli është i mendimit deri në këtë fazë se përfshirja e TFHS nuk ka kontribuar dukshëm në sigurimin e mbrojtjes efektive për të drejtat e saja. Në mungesë të informatave më të qarta dhe më të hollësishme rreth veprimeve dhe kontributit të TFHS për të hetuar këtë rast, Paneli duhet të nxjerrë përfundimin e nevojshme se të drejtat e ankueses kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të shkelura. Posaçërisht kjo është e vërtetë sa i përket të drejtave të saja (procedurale) sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës, si dhe të drejtave të saja për qasje në mjet efektiv juridik dhe për gëzimin e plotë të të drejtave të saja familjare (përkatësisht nenet 13 dhe 8 të Konventës).

Konfidencialiteti i hetimeve të ndjeshme penale dhe mbrojtja e të drejtave të viktimave

72. Shefi i Misionit me të drejtë i është referuar rëndësisë dhe nevojës për të garantuar një nivel të mjaftueshëm të konfidencialitetit për të mbrojtur integritetin e përpjekjeve të vazhdueshme hetimore.

Konfidencialiteti është i domosdoshëm dhe i justifikuar, veçanërisht në një rast si ky, ku mbrojtja e dëshmitarëve dhe informatorëve është kryesore. Në një rast të tillë, Paneli nuk sugjeronë se viktimat kanë të drejtë, si çështje e të drejtës, në zbulimin e plotë apo të pakufizuar të të gjithë dosjes hetimore, e as të një përmbledhjeje gjithëpërfshirëse të çështjes.

73. Megjithatë, Paneli konstaton se si çështje e ligjit të të drejtave të njeriut, viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, të afërmit e tyre si dhe në një masë më të vogël publiku i përgjithshëm në parim kanë të drejtë që të jenë të informuar mjaftueshëm rreth natyrës së hetimit (*Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lartë, §§ 311-314, 6 prill 2004; *Isayeva kundër Rusisë*, cituar më lartë, § 211-214; *Al-shkul dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 55721/07, 7 korrik 2011 §167, GjDNj 2011). Kjo ka për qëllim që të siguroj se të dyja autoritetet të veprojnë në të gjitha rastet me zell dhe kujdes të nevojshëm dhe që të sigurohet që do të ofrohet përgjegjësi e duhur sa i përket të drejtave të viktimave. Ndërsa është vështirë që të tërhiqet ndonjë vijë në mënyrë abstrakte, informacioni i siguruar për ata që ishin më së shumti të prekur drejtpërdrejtë nga hetimi duhet të jetë i tillë që t'u mundësoj atyre të binden se çështja është duke u analizuar në mënyrë të rregullt dhe siç duhet dhe se të gjitha përpjekjet e rëndësishme dhe të arsyeshme janë duke u bërë për ta vërtetuar fatin e të afërmeve të tyre dhe për t'i identifikuar përgjegjësit për të.
74. Në bazë të informatave në dispozicion, Paneli mendon se Misioni nuk ka arritur t'i siguroj informacion të mjaftueshëm ankueses lidhur me këtë hetim dhe për të bërë këtë në një mënyrë dhe me afat kohor të nevojshëm dhe të përshtatshme për lëndën. Misioni nuk ka dhënë arsye që arsyeton për shembull se të afërmit nuk kanë mundur të jenë rregullisht të informuar rreth përparimeve rreth hetimit apo se pse atyre nuk është mundur t'ju thuhej në mënyrë të përgjithshme se çfarë përpjekjesh ishin duke u bërë dhe se deri ku kishte përparuar çështja. E Misioni as edhe nuk kishte shpjeguar mungesën e aktivitetit në këtë çështje e as paaftësinë e vet ose dështimin për të siguruar më shumë informacion për ankuesen. Paneli rithekson rëndësinë se një organ hetimor pritet që të veprojnë në një shkallë aktive në informimin e viktimës apo të të afërmeve të ngushtë të viktimës dhe për të treguar masën e nevojshme të kujdesit në trajtimin e shqetësimit emocional që viktimat me gjasë ballafaqohen gjatë komunikimit me ta. Sjellja e Misionit në rastin konkret nuk e plotëson këtë standard.

PËR KËTO ARSYE

Paneli, njëzëri

SHBALL ANKESAT LIDHUR ME NENET 2 DHE 3 (PJESËT PROCEDURALE) DHE NENET 8 DHE 13 TË KONVENTËS TË PRANUESHME,

GJEN NJË SHKELJE TË KËTYRE TË DREJTAVE, dhe

DEKLARON se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme që të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses që i atribuohen veprimeve [dhe/ose mosveprimet] të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;
- b. ShM-ja duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit, të cilët janë në kontakt me viktimat e supozuara të shkeljes së të drejtave (ose të afërmeve të tyre) që të sigurojnë se në të gjitha komunikimet me ta të komunikojnë me masën e nevojshme të shpejtësisë, zellit dhe kujdesit të domosdoshëm për ta ditur vuajtjen emocionale të bashkëbiseduesit të tyre. Nëse është e nevojshme, ShM-ja duhet të konsideroj miratimin e udhëzimeve në më shumë hollësi se çfarë mund të nënkupton në rrethana konkrete ky udhëzim i përgjithshëm.
- c. ShM-ja duhet të siguroj që të gjitha organet hetuese në kuadër të Misionit (të TFHS dhe prokurorëve të EULEX-it) kanë në dispozicion burimet e nevojshme dhe mbështetje për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve aty. Për këtë qëllim dhe nëse konsiderohet e nevojshme ShM-ja duhet të kërkoj burime shtesë për këto organe në mënyrë që ata të mund të kryejnë funksionet e tyre shpejtë, me kujdes dhe në mënyrë efektive në të gjitha rastet.
- d. ShM-ja duhet të kërkoj që të qartësohet marrëdhënia midis Misionit dhe TFHS-së me qëllim që të sigurohet mbrojtja efektive e të drejtave dhe të garantohet se secili organ që është në krye të çështjes ofron informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm për ankuesit. Nëse është e nevojshme, duhet të kërkohet autorizimi nga BE-ja për të bërë publike bazën ligjore që rregullon punën e TFHS-së. Kjo gjithashtu në masë të madhe do të kontribuoj në sjelljen e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe për këtë mekanizëm.
- e. ShM-ja duhet t'ia bëjë të ditur TFHS-në dhe shteteve që mbështesin aktivitetet e tij rëndësinë që rastet e tilla duhet të hetohen në mënyrë të plotë dhe efektive dhe se kudo që të dyshuarit të identifikohen, të sillen para drejtësisë menjëherë dhe në mënyrë të drejtë.

- f. ShM-ja duhet t'ia bëjë të ditur zyrtarët kompetentë të TFHS-së rëndësinë dhe nevojën për të informuar viktimat rreth aspekteve të përgjithshme të hetimit të tyre në mënyrë që t'i njoftojnë ata rreth përpjekjeve dhe angazhimit të tyre për të arritur drejtësinë për ta.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese